

VENDIM
Nr. 393, datë 3.5.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 543, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “NEW BORN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 543, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen disa shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje.

“2.1 Bashkia Durrës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “Mane TCP”, lidh kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike.

2.2. Së bashku me kërkesën, investitori strategjik “Mane TCP” duhet të paraqesë pranë Bashkisë Durrës edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstrakt të 3 muajve të fundit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Planvendosje të sipërfaqes për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e qeverisjes vendore;
- Përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Përdorimi i brigjeve të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror 15 maj - 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës. Kjo tarifë të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen, objekt kontrate, sipas pikave 2.1 dhe 2.2, më sipër, të lidhur me Bashkinë Durrës, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi